



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:059981

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05489624

PS.nr.5/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI SPECIAL—në përbërje nga Kryetari i trupit gjykues – Gjyqtari Kujtim Krasniqi, anëtarët – gjyqtarët profesional, Lutfi Shala dhe Mentor Bajraktari, me bashkëpunëtorin profesional Laurant Avdyli, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.K. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 par. 1 nen-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së, dhe për shkak të veprës penale Pastrimi i parave nga neni 308 i KPRK-së dhe nenit 56 të ligjit 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit, sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.67/19 të datës 21.05.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor verbal e publik, në të cilën kanë qenë të pranishëm Prokurorja e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Habibe Salihu, i akuzuari B.K. me mbrojtësin e tij me autorizim av.Visar Haxhibeqiri, me datën 14.02.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 22.03.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.K. i biri i S., dhe H., e vajzërisë M., i lindur me ... në P., me vendbanim rr. "U." nr... në P., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, punon tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i 4 fëmije, me numër personal: ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 363, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPPK-së

LIROHET NGA AKUZA

SEPSE:

I pandehuri B.K., në llogarinë individuale me në TEB Bank në pronësi të të pandehurit SK. ka realizuar deponime kesh nga data 05.07.2013 me një deponim në shumën 13.000.00 euro, nga rrjedh se nuk është justifikuar prejardhja e parave të transferuara brenda dhe jashtë vendit e që në rastin konkret të pandehurit e lartcekur janë munduar ta fshehin apo maskojnë natyrën e vërtetë apo burimin e kësaj pasurie që kapë shumën totale prej të gjitha deponimeve dhe transferove brenda në Kosovë nga të gjithë të pandehurit e lartcekur, arrin shumen në total

11,565,471.92€ ndërsa shuma që të pandehurit e lartcekur, kanë realizuar transfere të jashtme arrin në totale 6,860,133.84 euro dhe 26,990.00 \$, ku gjithsejtë qarkullimi brenda dhe jashtë Kosovë arrin në shumë totale 18,425,605.76 euro dhe 26,990.00 \$, e cila shumë ju referohet të pandehurve, që nënkupton shumën e parave të shpërlara, ashtu që sipas të dhënave të gjetura lidhur me deponimet, transferet dhe importet e realizuara nga këto subjekte afariste, rrjedh se veprimet e tyre të pajustificuara, trajtohen si pastrim i parave, dhe janë kryer në bashkëveprim nga të pandehurit e lartcekur-

- Me çka kishte për të kryer veprën penale **Pastrimi i parave nga neni 308 i KPRK-së dhe nenit 56 dhe 57 të ligjit 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit, lidhur me veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 81 par. 1 nen-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të KPRK-së.**
- Për shkak se nuk është provuar se e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.
- Shpenzimet e procedurës penale bien barrë e buxhetit të gjykatës

Arsyetim

Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me aktakuzën PPS.nr.67/19 të datës 21.05.2021, ka akuzuar të akuzuarve SK., A.D., N. E., N. E., H. E., R. N., B. B., B. B., F. M., për shkak të veprave penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 par. 1 nën-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së dhe për shkak të veprës penale Pastrimi i parave nga neni 308 i KPRK-së dhe veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm të KPRK-së, Z. Z., B. A., N. P., B. B., T. D., D. Sh., B. S., A. H., A. L., B. I., P. N., A.B., A. R., I. J., I. V., S. B. për shkak të veprave penale në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 31 dhe nenin 81 par. 1 nen-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 të KPRK-së, P. N. për shkak të veprës penale Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 të KPRK-së dhe A. K. për shkak të veprës penale Ndhurma nga neni 33 par.2, lidhur me veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 81 par. 1 nen-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur në vazhdim seancat e shqyrtimit gjyqësorë për të akuzuarit, ndërsa pas leximit të aktakuzës, me rastin e deklarimit të të akuzuarve lidhur me çështjen e fajësisë në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPPRK-së, të akuzuarit, kanë deklaruar se nuk ndihen fajtor dhe nuk e pranojnë fajësinë, me që të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për aktakuzën në fjalë, gjykata duke u bazuar në nenin 323 par. 1 nën paragrafi 1.2 të KPPRK-së, ka vazhduar me fjalën hyrëse, me prezantimin e provave personale dhe materiale. Ndërsa para fjalës përfundimtare gjykata me aktvendim ka veçuar procedurën për të akuzuarin B.K. për shkak të

ekonomizimit të procedurës pasi që i njëjti ishte jashtë vendit në kohën kur po mbahej shqyrtimi gjyqësor për rastin konkret.

Fjala Hyrëse e palëve

Shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse të palëve, ashtu që Prokurorja e PSRK-së Habibe Salihu dhe palët tjera në procedurë, kanë përmbledhur provat që mbështesin pretendimet e Akuzës si dhe teorinë e mbrojtjes si dhe kërkesat e tyre, ndërsa më pastaj në procedurën e provave shqyrtimi gjyqësorë ka vazhduar me dëshminë e dëshmitarëve, provat materiale, si dhe mbrojtjen e të akuzuarve.

Provat e administruara dhe të vlerësuara

- Gjykata lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike ka administruar provat siç janë dëshmitë e dëshmitarëve, G.M., D.S., V.B., A.B., R.G., V.R., B.N. si dhe provat materiale:
- Njoftim nga ARBK për verifikimin e informative te bizneseve,
- Përgjigje nga ATK lidhur me pronaret e bizneseve,
- Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve tjera nga ATK,
- Përgjigje nga ATK lidhur me regjistrimin e personave dhe subjekteve si tatimpagues,
- Raporti e ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë,
- Raporti përmbledhës i kontrollit neper pika, dt. 13.04.2018;
- Formular nga BQK;

Dëshmitari G. M. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **09.03.2023** ka deklaruar se në vitin 2014 kishte punuar në administratën e firmës “B.T.”, e cila tha se kishte qenë depo ushqimore me pronar B.K.. Tutje ka deklaruar se përgjegjësitë e tij kishin qenë për të bërë faturat e shitjes, ku blerësit kishin kërkuar artikuj të caktuar dhe ai ua kishte bërë faturat dhe kishte bërë deponimin e mjeteve në emër të firmës. Pazarit ditor kishte qenë diku 15 deri në 20 mijë euro dhe mjetet e deponuara në bankë janë bërë më përshkrimin “Pazar ditor”. Deponimet kanë qenë ditore dhe të njëjtat janë bërë edhe prej kolegëve të tjerë.

Dëshmitari D.S. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **09.03.2023** ka deklaruar se gjatë periudhës 2013-2022 ka punuar në “B.T.” Sh.P.K si komercialist-shitës. Të akuzuarin B.K. e njeh si pronar të kësaj depo dhe si shef të tij gjatë periudhës sa kishte punuar aty. Tutje ka deklaruar se detyra e tij kishte qenë që të bënte porositë sipas kërkesave të klientëve, ndërsa pazarit ditor tha se varionte nga dita në ditë dhe nga sezoni në sezone, duke shkuar nga 8 deri 10 mijë ditëve normale ndërkaq deri në 25 mijë euro në sezonin e verës. Deponimi i parave në emër të kompanisë ishte bërë në baza ditore nga ai dhe të gjithë punëtorët e tjerë të cilët kanë qenë të lirë, me përshkrimin “Pazar ditor”. Për deponimin e mjeteve autorizim nuk ka pas por përderisa i kanë deponuar në emër të firmës, në bankë nuk kanë pas asnjë problem. Dëftesën në bankë e kanë marrë dhe deponimi është bërë në baza ditore sipas pazarit ditor, kurse arkëtari i

ka dorëzuar parat tek ata, e pastaj i kanë dorëzuar në bankë dhe dëftesën e kanë kthyer në arkë për barazim. Përveç arkëtarit në raste të rralla edhe B. ju ka dhënë mjete për me deponim.

Dëshmitari V.B. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **09.03.2023**, ka deklaruar senë vitin 2014-2015 kishte deponuar dy herë mjete materiale në llogarinë e të akuzuarit SK., shuma e të cilave tha se nuk i kujtohet. Këto mjete ishin deponuar me qëllim të shkollimit të djalit të të akuzuarit SK. duke shtuar se këto mjete ishin të tij dhe nuk e di prejardhjen e tyre.

Dëshmitari A.B. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **09.03.2023**, ka deklaruar se punon në kompaninë “B.T.”, që nga viti 2000 në bartjen e mallrave, e cila firmë tha se është e të akuzuarit B.K.. I njëjti tha se kishte bërë disa deponime në bankë në emër të firmës me përshkrimin “Pazar ditor”, të cilat tha se ia kishte dhënë i akuzuari Kyqyku. Shumat kanë qenë të ndryshme herë 8000 euro e herë 10.000 euro. Deponimet i ka bërë çdo tre katër ditë.

Dëshmitari R.G. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **09.03.2023**, ka deklaruar se punon në firmën “B.T.” si depoist por që kishte bërë edhe deponime në bankë në emër të firmës kur kishte pasur nevojë me përshkrimin “Pazar ditor”. I njëjti tha se të hollat ia kishte dhënë arkëtari V.R. dhe shumat kishin qenë të ndryshme.

Dëshmitari V.R. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **09.03.2023**, ka deklaruar se punon në “B.T.” si arkëtar që nga viti 2013, pronar i të cilit është B.K.. I njëjti theksoj se detyra e tij është të kryejë pagesat e kolegëve që marrin porosinë e mallrave, ku shuma e pagesave gjatë sezonit të verës variojnë nga 35 mijë deri në 40 mijë euro ndërkaq ditëve normale nga 8 mijë deri në 11 mijë euro. Deponimi bëhet nga kolegët e tij, ndërkaq pazarin ditor tha se ia dorëzon B.K.t i cili më pas ua jep kolegëve të autorizuar për deponime. Sipas tij, këto deponime nuk bëhen me shkresë por vetëm mblidhet pazari, kalkulohet shuma, dhe i jepet personit për deponim në bankë. Ai tha se deri në ora 15:00 pazari ditor dorëzohet në po të njëjtën ditë ndërsa mbas orës 15:00 pazarin i’a dorëzon B. e ai i dorëzon në bankë ato. Sa i përket autorizimeve për me bo deponime në bankë ka deklaruar se me këto merret Bekimi, por për nevoja e tija e ka shkruar një faturë me shumën sa para ja ka dorëzuar punëtorit dhe kur ja ka pru letrën e bankës për tu barazuar se a është njëjtë. Punëtorët që kanë deponuar mjete kanë qenë punëtor të depos, kurse arsyeja pse nuk ka shkruar personalisht me bo pagesa ka qenë se është dashtë të qëndrojë në arkë dhe nuk ka pas zëvendësim.

Dëshmitari B.N. në dëshminë e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës **30.06.2022**, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës së dhënë në polici me datën 04.08.2020 ku qëndron prapa saj. Tutje ka sqaruar se dokumentacionin që e ka përmend në deklarata nuk e ka dorëzuar në Prishtinë, por ka ardhë në Prizren ATK-ja dhe ja ka kërkuar me ja përgatit dokumentacionin për vitet të cilat i ka deklaruar në deklaratë dhe ja kam dorëzuar ATK-së.

Mbrojtja e te akuzuarit

I akuzuari B.K., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se asnjë nga të akuzuarit nuk i njeh, përveç të akuzuarit SK. të cilin e ka vëlla. Sipas tij, asnjëherë nuk kishte ndodhur që të akuzuarve t'i huazojë para, përveç vëllait të tij S. të cilit ja ka huazuar shumën prej 13.000 euro përmes bankës TEB dhe këtë shumë e ka marrë nga fitimet prej biznesit të tij. Sa i përket lojërave të fatit ka deklaruar se gjithmonë është marrë me tregti dhe se asnjëherë nuk kishte qenë pronar ose menaxher i ndonjë biznesi që ka ushtruar veprimtarinë e lojërave të fatit.

Fjala përfundimtare e palëve

PSRK në fjalën përfundimtare të dorëzuar në formë të shkruar dhe të elaboruar edhe verbalisht në seancën e shqyrtimit gjyqësor i ka përmbledhur dhe përshkruar provat personale dhe materiale të cilat argumentojnë faktet në lidhje me veprimet e të akuzuarit të përshkruara si në dispozitiv të aktakuzës, dhe përfundimisht gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit dhe me rastin e marrjes së vendimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit.

Pretendimet e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.K., av. Visar Haxhibeqiri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fjalën përfundimtare e ka përgatitur me shkrim dhe e ka elaboruar në seancë, duke konsideruar se nuk është provuar aktakuza e prokurorisë dhe gjykatës i ka propozuar të akuzuarin ta liroj nga Aktakuza.

I akuzuari B.K., në fjalën përfundimtare deklaroj se e përkrahë fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij dhe nuk ka tjetër se çfarë të shtoj.

Arsyetimi i vendimit mbi faktet e vërtetuara dhe jo të vërtetuara

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate Arsyetimi nuk ka për qëllim të jetë përsëritje e materialit të provave, funksioni i tij është ta mundësojë të kuptuarit e vendimit lidhur me vërtetimin ose jo të fakteve. Fillimisht do të bëhet vlerësim i fakteve të përgjithshme mbi secilin lloj të provës dhe pastaj do të bëhen edhe disa referime specifike për secilin fakt, apo së paku për grumbuj faktesh. Rreth sferës së arsyetimit, në referim të nenit 6 të konventës evropiane për të Drejtën në Gjykim të Drejtë dhe praktikës së ndërtuar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, arsyetimi i vendimeve gjyqësore – Sipas praktikës juridike që reflekton një parim të lidhur me ndarjen e duhur të drejtësisë, aktgjykimet e gjykatave duhet t'i shpallin qartë arsyet mbi të cilat ato bazohen, Vendimet e arsyetuara i shërbejnë qëllimit të demonstrimit palëve se ata janë dëgjuar, duke kontribuar kështu në një pranim më të gatshëm të vendimit nga ana e tyre. Përveç kësaj, ato i obligojnë gjykatën që ta bazojnë arsyetimin e tyre në argumentet objektive si dhe t'i ruajnë të drejtat e mbrojtjes. Megjithatë, shkalla e detyrës për të dhënë arsyetim ndryshon sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në aspektin e rrethanave të rastit. Ndonëse gjykatat nuk

janë të obliguara të japin përgjigje të hollësishme për secilin argument të ngritur, por duhet të jetë e qartë nga vendimi se janë trajtuar çështjet thelbësore të rastit. Gjykatat duhet t'i cekin me qartësi të mjaftueshme bazat në të cilat i bazojnë vendimet e tyre me qëllim që t'i mundësohet një palë ndërgjyqëse që t'i ushtrojë të drejtat për ankesë në raste të pakënaqësisë me vendimin e gjykatës, andaj nga kjo rezulton se gjykatat janë të obliguara të japin sqarime në lidhje me provat relevante të cilat vërtetojnë gjendjen faktike të dispozitivit të aktgjykimit, por jo edhe domosdoshmërisht edhe provat të cilat janë shqyrtuar në shqyrtim gjyqësorë e që nuk kanë fuqi provuese qoftë direkte apo rrethanore në lidhje me rastin i cili është objekt i këtij gjykimi, ashtu që gjykata në arsyetimin e këtij aktgjykimi do të sqarojë të gjitha provat relevante secilën veç e veç si dhe në lidhmëni me njëra tjetrën për të arsyetuar vendimin e gjykatës.

Analizimi në tërësi në aspektin ligjor.

Gjykata sjellë në vëmendje se, përgjegjësia penale është detyrimi ligjor i çdokujt, që shkel një rregullim normativ me karakter penal, për t'iu nënshtuar pasojave ligjore me karakter ndëshkues e parandalues. Nisur nga rëndësia që kanë, organet proceduese penale përgjatë të gjithë veprimtarisë që përbën në tërësi procedimin penal, nga intensiteti i madh i kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të subjekteve të nënshtuara dhe nga nevoja për zhvillimin e një procedimi të ndershëm, të rregullt dhe tërësisht në përputhje me ligjin, Kodi Penal ka parashikuar disa kushte kumulative që duhet të përmbushen në çdo procedim penal. Legjislacioni duke konkretizuar parimin e ligjshmërisë të shprehur në nenin 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, ka parashikuar edhe llojet e veprave penale dhe llojet apo masat përkatëse të dënimeve për to. Sipas të drejtës sonë penale, e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar veprave penale, të parashikuar nga ligji penal. Për këtë arsye, bashkë ekzistenca e njëkohshme e elementeve të figurës së veprës penale ka një rëndësi të madhe sepse lidhet domosdoshmërisht me zbatimin e parimit të ligjshmërisë.

Gjykata gjithashtu thekson se barra e të provuarit, se i pandehuri është fajtor për veprën penale, i përket prokurorisë si organ i ndjekjes ashtu që prokuroria është e obliguar që të vërtetojë me prova, se ekziston përtej dyshimit mirë të bazuar, se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat ngarkohet. Gjykata, në trajtën e jurisprudencës praktike, orientoi dhe zbatoi lidhshmërinë vepruese dhe vendimmarrjen meritore mbi bazën provuese në këtë çështje penale, në lidhje me nenin 360 të KPPRK-së (*Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.*). Andaj, gjykata në rrjedhën obliguese të zbatimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë formale në proceset penale, në pajtim me nenin 22 në ndërlidhje me nenin 53 të Kushtetues së Republikës së Kosovës, veprimi në të njëjtën linjë arsyettuese me praktikën e GJEDNJ, e cila në vendimin e saj të datës 10 shkurt 1995, çështja *Allenet de Ribemont kundër Francës*, ndër të tjera arsyetoi: *Prezumimi i pafajësisë i parashikuar në paragrafin e 2 të nenit 6 është një ndër elementët e një procesi penal të drejtë siç kërkohet nga paragrafi 1 (shih veçanërisht vendimin Denwer kundër Belgjikës, datë 20 shkurt 1980). Ky parim shkelet në qoftë se një vendim gjyqësor lidhur me një person të akuzuar për kryerjen e një veprave penale pasqyron një mendim paraprak se ai është fajtor kur fajësia e tij nuk është provuar ende*

në bazë të ligjit. Madje edhe nëse nuk ka ende një konstatim formal, ka shkelje edhe kur gjatë arsyetimit del se gjyqtari e konsideron të pandehurin fajtor. Andaj, vendosja meritore e gjykatës ishte rrjedhë e orientuar nën kualifikimet juridike nga materiali provues në këtë çështje penale, ashtu që materialet provuese nuk arsyetuan asnjë materializim kuantitativ të ekzistencës së dyshimit në procesin e të provuarit penal në këtë çështje penale.

Në aspektin procedural penal, i akuzuari mbulohet nga parimi i prezumimit të pafajësisë si dhe parimi *In Dubio Pro Reo* (*Mëdyshjet lidhur me provat dhe faktet si dhe zbatimit të ligjit zbatohen në favor të të pandehurit*), po ashtu i akuzuari nuk është i detyruar që ta provoj fajësinë apo pafajësinë e tij. Po ashtu, tërësia e normave të zbatueshme nga legjislacioni penal në Republikën e Kosovës, në mënyre takstative, por dhe nga atributet provuese që burojnë nga interpretimi deduktiv i ligjshmërisë obliguese në trajtën e vendosjes së gjykatës, përcaktojnë ndërtimin e vendimmarrjes gjyqësore, ndryshe nga ajo se si është vendosur në këtë aktgjykim, vetëm mbi bazën e epërsisë së provave që nënkupton provueshmërinë se çështja penale ka më shumë të ngjarë të ekzistojë se sa jo, ashtu që në këtë çështje penale prokuroria nuk ka vërtetuar në asnjë rrethanë përgjegjësinë penale të pandehurit. Në këtë linjë arsyetuese qëndron vendimmarrja praktike e vendosjes gjyqësore të GJEDNJ, ashtu që gjykata ka trajtuar se, prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, *pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie mbi organin e akuzës, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza. Konkretisht, GJEDNJ është shprehur se: “Përpjekja për të detyruar të akuzuarin të sigurojë prova në lidhje me veprat që ai dyshohet se ka kryer, shkel të drejtën e tij për të qëndruar në heshtje dhe të drejtën për mos kontribuar në vetë inkriminim. Çështja Funke kundër Francës, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10828/84), 25 Shkurt 1993.*

Po ashtu, edhe pse dispozita e nenit 325 par.4 të KPPRK-së, e parashikon të drejtën e Gjykatës që *“Përveç provave të propozuara nga palët dhe e dëmtuara, gjyqtari i vetëm gjykues ka të drejtë të shqyrtojë provën që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale”*, kjo dispozitë procedurale nuk e kthen gjykatën në palë, për të siguruar prova, në procesin penal sepse në të kundërtën do të shkelet parimi i paanshmërisë dhe do të zhveshët nga autoriteti që realizon dhënien e drejtësisë dhe do të merr rolin e autoritetit ndjekës, andaj gjykata nuk ka vlerësuar të domosdoshme dhe të nevojshme për të marrë prova shtesë për ndriçimin e gjendjes faktike pasi që ka konsideruar se provat e administruara gjate këtij shqyrtimi gjyqësorë kanë qenë të mjaftueshme për vërtetimin e drejtë të plotë të gjendjes faktike.

Që i akuzuari të gjendet fajtor nga gjykata, duhet të provohet se aktakuza e ngritur nga prokuroria është e provuar dhe argumentuar përtej dyshimit të bazuar mirë, e që në rastin konkret prokuroria nuk ka mundë ta bindë gjykatën se me provat e propozuara dhe administruar në shqyrtim gjyqësor i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës. Prezumimi i pa fajësisë dhe barra e të provuarit janë kërkesa imperative dhe të artikuluar në të gjitha të drejtat dhe konventat ndërkombëtar mbi të drejtat e njeriut, e të cilat janë inkorporuar në nenin 3 të KPPRK-së (*Prezumimi i pafajësisë së të pandehurit dhe Parimi In Dubio Pro Reo*) dhe nenin 7 par.1 të KPPRK-së, që nënkupton detyrimin e përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë

të fakteve, këto konstatime gjejnë mbështetje në nenin 11 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 6 par.2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 14 par.2 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Andaj, Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale në shqyrtim gjyqësor, të njëjtat në bazë të nenit 360 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë, vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal, profesional dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhmëni me njëra tjetrën si tërësi dhe si rezultat i vlerësimit të tyre ka ardhur në përfundim se nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pretendimet e aktakuzës

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, e në referim të përshkrimit faktik të aktakuzës PPS.nr.67/19 të datës 21.05.2021 “i akuzuari B.K., në llogarinë individuale me në TEB Bank në pronësi të të pandehurit SK. ka realizuar deponime kesh nga data 05.07.2013 me një deponim në shumën 13.000.00 euro, nga rrjedh se nuk është justifikuar prejardhja e parave të transferuara brenda dhe jashtë vendit e që në rastin konkret të pandehurit e lartcekur janë munduar ta fshehin apo maskojnë natyrën e vërtetë apo burimin e kësaj pasurie që kapë shumën totale prej të gjitha deponimeve dhe transferove brenda ne Kosovë nga të gjithë të pandehurit e lartcekur, arrin shumen në total 11,565,471.92€ ndërsa shuma që të pandehurit e lartcekur, kanë realizuar transfere të jashtme arrin në totale 6,860,133.84 euro dhe 26,990.00 \$, ku gjithsejtë qarkullimi brenda dhe jashtë Kosove arrin në shumë totale 18,425,605.76 euro dhe 26,990.00 \$, e cila shumë ju referohet të pandehurve, që nënkupton shumën e parave të shpërlara, ashtu që sipas të dhënave të gjetura lidhur me deponimet, transferet dhe importet e realizuara nga këto subjekte afariste, rrjedh se veprimet e tyre të pajustificuara, trajtohen si pastrim i parave, dhe janë kryer në bashkëveprim nga të pandehurit e lartcekur-”, nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, nuk është vërtetuar se i akuzuari këto para kanë qenë për qëllime të pastrimit të tyre.

Edhe aktakuza përmban disa dispozitiva, gjykata me kujdes ka analizuar të gjitha dispozitivët, ndërsa i vetmin përshkrim faktik që ka të bëjë më të akuzuarin B.K. është përshkrimi faktik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në vlerësim të këtij dispozitivi edhe pse prokuroria të akuzuarin e akuzon për veprat penale “Pastrimi i parave nga neni 308 i KPRK-së dhe neni 56 dhe 57 të ligjit 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit, lidhur me veprën penale Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 81 par. 1 nen-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të KPRK-së, nuk është përshkruar asnjë veprim inkriminues sa i përket veprës penale bazë Organizimi i skemave piramidale dhe i bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par. 2 lidhur me nenin 81 par. 1 nen-par. 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5, të KPRK-së e po ashtu për bashkëkryerjen, ndërsa për veprën penale Pastrimi i parave nga neni 308 i KPRK-së, janë përshkruar vetëm transaksione bankare ne formë huaje, pa dhënë ndonjë argumentim në lidhje me burimin e mjeteve financiare për të argumentuar kundërligjshmërinë e tyre si kërkesë ligjore e që sipas dispozitës për të ekzistuar vepra penale Pastrimi i parave nga neni 308 i KPRK-së duhet që mjetet financiare të janë fituar me vepër penale, ose me ndonjë aktivitet kriminal.

Për me tepër për gjykatë nuk ishte kontestues fakti se B.K. dhe SK. janë vëllezër. Po ashtu nuk ishte kontestuese se B.K. merret me biznes, dhe biznesi i tij ishte tregtia, ku është pronar i biznesit NTP “B.T.”.

Nuk ishte kontestues as fakti se fillimisht bashkëpronar i këtij biznesi ka qenë edhe SK. por nga viti 2009 si pronar i vetëm figuron të jetë i akuzuari B.K..

Për gjykatën nuk ishte kontestues as fakti se i akuzuari, vëllait të tij SK.t i ka dhënë para përmes transaksionit bankar në vitin 2013, shumën prej 13.000 euro.

Për gjykatën kontestues ishte nëse kjo shumë e parave i është dhënë si formë e mbulesës së ndonjë aktiviteti kriminal me qëllim të pastrimit të parave.

Gjykata duke analizuar dispozitën ligjore të veprës penale shpëlarja e parave sipas nenit 308 të KPRK-së, i cili përcakton se *“Kushdo që kryen veprë penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.”*

Ligji 05/L-096 mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit, përcakton se pastrimi i parave është veprë e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë vlerën e pasurisë që është objekt i veprës penale, ashtu që në nenin 56 potencon *Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës: 2.1. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë; 2.3. konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të shmangies së detyrimit të raportimit sipas këtij ligji; 2.8 kryen veprë penale të dënueshme me një afat burgosjeje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale.*

Pastrimi i parave përmbajtëson një gamë të gjerë të aktiviteteve dhe proceseve me qëllim errësimin e burimit të të hollave të fituara në mënyrë të paligjshme dhe për të krijuar pamjen se ato e kanë origjinën nga një burim legjitim. Pra, pastrimi i parave është “transferimi i të hollave dhe pasurisë tjetër të nxjerra në rrugë të kundërligjshme ose investimi për të fshehur burimin e vërtetë, si një veprimtari e fshehtë, në procesin e maskimit të origjinës reale të përfitimeve kriminale, të transformimit të tyre në kapital legjitim.

Po ashtu, gjykata në linjën arsyetuese, gjeti se Neni 1 i Konventës së Këshillit të Evropës “Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimit dhe Për Financimin e Terrorizmit” jep këtë përkufizim: “Për qëllime të kësaj Konvente: a) “produkt” nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nën paragrafin b të këtij neni; b) “pasuri” nënkupton pasuri të çdo

natyre, fizike ose jo fizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri.

Andaj, gjykata, në intencën absolute të vendimmarrjes së drejtë gjyqësore dhe meritore, gjeti se prokuroria në asnjë rrethanë provuese nuk provoi burimin financiar të supozuar si të krijuar nga paligjshmëria dhe aktiviteti kriminal i krijimit të tij, andaj gjykata në relacionet arsyetuese dhe konkluzionet vendimmarrëse në konkluzionet logjike dhe juridike nga prizmi analog i përmbajtës si më poshtë shqyrtoi se GJENDJ është shprehur se, qasja e jurisprudencës së gjykatave belge, sipas të cilave, *që një i dyshuar të mbajë përgjegjësi penale për pastrim e parave, është e mjaftueshme të përcaktohet origjina e paligjshme dhe dijenia e personit, pa qenë nevoja e përcaktimit të veprës penale specifike dhe mbi bazën e fakteve, gjyqtari mund të përjashtojë çdo burim ose origjinë të ligjshme të pasurisë, nuk ka asgjë të gabuar, për më tepër, është në përputhje me nenet 9/3 dhe 6 të Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin e parave, sipas gjykatës kjo qasje nuk përbën në vetvete shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 6/1/2 i KEDNJ. Zschüschen v. Belgium (application no. 23572/07), vendimi datë 02.05.2017.*

Nga provat personale dhe material të administruara në shqyrtim gjyqësor, nuk u vërtetua se i akuzuari ka kryer veprën e cila i vihet në barrë.

Gjykata arriti të vërtetoj se B.K. ushtron aktivitetin e tij biznesor për një kohë të gjatë, se pagesat dhe te hyrat e tij janë te evidentueshme dhe te deklaruar për tatim dhe se përveç te hyrave te rregullta nuk është vërtetuar se është pranuar ndonjë shumë te hollave jashtë ushtrimit te aktivitetit te tij te rregullt dhe te ligjshëm biznesor. Po ashtu gjykata arriti të vërtetoj se i akuzuari nuk ka qenë asnjëherë pronar, bashkëpronar, rol drejtuesi apo përfitues si qiradhënës i ndonjë biznesi që ka ushtruar aktivitetin e lojërave të fatit.

Dëshmitari G. M. në dëshminë e tij para trupit gjykues ka deklaruar se në vitin 2014 kishte punuar në administratën e firmës “B.T.”, e cila tha se kishte qenë depo ushqimore me pronar B.K., dhe se pazari ditor kishte qenë diku 15 deri në 20 mijë euro dhe mjetet e deponuara në bankë janë bërë më përshkrimin “Pazar ditor”,

Dëshmitari D.S. në dëshminë e tij para trupit gjykues ka deklaruar se gjatë periudhës 2013-2022 ka punuar në “B.T.” Sh.P.K si komercialist-shitës. Të akuzuarin B.K. e njeh si pronar të kësaj depo dhe si shef të tij gjatë periudhës sa kishte punuar aty. Tutje ka deklaruar se detyra e tij kishte qenë që të bënte porositë sipas kërkesave të klientëve, ndërsa pazari ditor tha se varionte nga dita në ditë dhe nga sezoni në sezone, duke shkuar nga 8 deri 10 mijë ditëve normale ndërkaq deri në 25 mijë euro në sezonin e verës. Deponimi i parave në emër të kompanisë ishte bërë në baza ditore nga ai dhe të gjithë punëtorët e tjerë të cilët kanë qenë të lirë, me përshkrimin “Pazar ditor”,

Dëshmitari A.B. në dëshminë e tij para trupit gjykues ka deklaruar se punon në kompaninë “B.T.”, që nga viti 2000 në bartjen e mallrave, e cila firmë tha se është e të akuzuarit B.K.. I njëjti tha se kishte bërë disa deponime në bankë në emër të firmës me përshkrimin “Pazar ditor”,

të cilat tha se ia kishte dhënë i akuzuari K.. shumat kanë qenë të ndryshme herë 8000 euro e herë 10.000 euro.

Dëshmitari R.G. në dëshminë e tij të dhënë para trupit gjykues, ka deklaruar se punon në firmën “B.T.” si depoist por që kishte bërë edhe deponime në bankë në emër të firmës kur kishte pasur nevojë me përshkrimin “Pazar ditor”.

Dëshmitari V.R. në dëshminë e tij të dhënë para trupit gjykues, ka deklaruar se punon në “B.T.” si arkëtar që nga viti 2013, pronar i të cilit është B.K.. I njëjti theksoj se detyra e tij është të kryejë pagesat e kolegëve që marrin porosinë e mallrave, ku shuma e pagesave gjatë sezonit të verës variojnë nga 35 mijë deri në 40 mijë euro ndërkaq ditëve normale nga 8 mijë deri në 11 mijë euro. Deponimi bëhet nga kolegët e tij, ndërkaq pazarin ditor tha se ia dorëzon B.K.t i cili më pas ua jep kolegëve të autorizuar për deponime.

Gjykata nga dëshmitë e këtyre dëshmitarëve vërtetoi faktin e pakontestueshëm se i akuzuari është pronar i firmës “B.T.” e cila është depo ushqimore, dhe kjo depo kishte qarkullime ditore 15 deri në 20 mijë euro të cilat shuma pastaj deponoheshin në bankë. I akuzuari për deponime të pazarit ditor ka angazhuar disa nga punëtorët e tij dhe të gjitha fitimet janë të deklaruara dhe të deponuara në bankë.

Sa i përket pronësisë se i akuzuari është pronar i vetëm i këtij biznesi u vërtetua edhe nga provat materiale, gjegjësisht nga njoftim nga ARBK për verifikimin e informative të bizneseve, përgjigja nga ATK lidhur me pronaret e bizneseve dhe përgjigje nga ATK lidhur me regjistrimin e personave dhe subjekteve si tatimpagues.

Lidhur me shumën prej 13.000 euro që i është dhënë SK.t nga ana e të akuzuarit, gjykata nuk mundi të vërtetoi se bëhet fjalë për shpërlarje të parave, ngase dëshmitari V.B. në dëshminë e tij të dhënë para trupit gjykues, ka deklaruar se në vitin 2014-2015 kishte deponuar dy herë mjete materiale në llogarinë e të akuzuarit SK., shuma e të cilave tha se nuk i kujtohet. Këto mjete ishin deponuar me qëllim të shkollimit të djalit të të akuzuarit SK..

Gjykata këtë dëshmi e vlerësoj si të besueshme ngase edhe vetë i akuzuari nuk e mohon se i ka transferuar SK.t para, duke potencuar se vëllait të tij S. të cilit ja ka huazuar shumën prej 13.000 euro përmes bankës TEB dhe këtë shumë e ka marrë nga fitimet prej biznesit të tij.

Gjykata vlerëson se ky transaksion nuk është bërë me qëllim të shpërlarjes së parave pasi që parat që janë transferuar janë para të ligjshme të cilat i akuzuari i ka fituar përmes biznesit të tij, dhe të cilat janë transferuar përmes transaksioneve bankare. Kjo shumë është transferuar në llogarinë e SK.t të cilin e ka edhe vëlla dhe se kjo rrethanë nuk paraqet veprim kriminal por paraqet një raport juridiko - civil e me sakte huazim, e mjete këto të cilat janë fituar në forme legale.

Sipas ekspertizës së ekspertit financiar Naser Prapashtica e datës 07.06.2018, në të cilën ka potencuar se Mjetet e huazuar në vlerë prej 13,000.00 € euro, në periudhë 2013, janë të ardhura

te ligjshme te realizuar nga shitja e mallrave përmes aktivitetit ekonomik te z.B.K., dhe nuk kanë të bëjnë aspak me të ardhura të pa ligjshme, por të ardhura qe janë gjeneruar nga aktiviteti ekonomik duke mbajtur libra dhe regjistrime sipas dhe ligjeve tatimore të Kosovës.

Po ashtu sa i përket vlerës se huazuar prej 20,000.00 € eurove, nga z.B.K., përmes biznesit Be & Sa Trade, për z.SK. sipas marrëveshjes mes dy palëve, mjete këto që janë huazuar përmes xhirollogarive bankare te dy palëve me date 12.04.2015, me kete rast nuk ishte bere asnjë shkelje ligjore dhe pa rregullsi, ky veprim është një hap kontraktual i cili nuk është i ndaluar me asnjë Ligj në Kosovë.

Gjykata këtë ekspertizë e vlerësoje si të besueshme dhe konkrete, është punuar në mënyrë profesionale duke argumentuar çështjet në lidhje me rastin konkret.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale, por nga to nuk ka arritur të vërtetoj ndonjë fakt relevant për çështjen konkrete.

Gjykata thekson se për të përcaktuar fajësinë dhe për të shpallur fajtor të akuzuarin, duhet të ketë prova bindëse dhe të pakontestueshme. Në rastin konkret provat nuk kanë qenë bindëse dhe në rast të mëdyshjeve lidhur me faktet dhe provat atëherë gjykata aplikon parimin In Dubio Pro Reo - *Mëdyshjet lidhur me provat dhe faktet si dhe zbatimin të ligjit zbatohen në favor të të pandehurit*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pra nga vet përshkrimi faktik i akuzës por edhe nga provat të cilat janë administruar në asnjë rrethanë nuk mund të vërtetohet dhe nuk mund të formohet përtej dyshimit mirë të bazuar se i akuzuari B.K. ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit:

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili gjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale ka pas sjellje korrekte me gjykatën ndërsa në raport me veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtim gjyqësorë është deklaruar i pa fajshëm, duke i mohuar në tersi veprimet inkriminuese të përshkruara në dispozitiv të aktakuzës, si dhe veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata rikujton, se vërtetimi i fakteve në procedurë penale realizohet nëpërmjet procesit të të provuarit, në dëm të të akuzuarit mund të merret fakti vetëm atëherë kur është vërtetuar pa mëdyshje, kur ekzistimi i tij qëndron përtej dyshimit mirë të bazuar.

Në mbështetje të nenit 7 të KPPRK-së, Gjykata, Prokurori dhe Policia, të përfshirë në procedurë penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrje të vendimit të ligjshëm.

Andaj, Gjykata arrin në përfundim se në referim provave të administruara, fakteve të vërtetuara, si dhe gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë, konform nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

të akuzuarin e liroj nga aktakuza, pasi që nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën të përshkruar si në aktakuzë

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të nenit 363 par.1, nën par.1.3 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti Special
PS.nr.5/2024, të datës 22.03.2024

Bashkëpunëtori profesional ,
Laurant Avdyli

Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari,
Kujtim Krasniqi

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.